



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Beqir Kalludra, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Zyhdi Haziri, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.A. nga fshati ..., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.1240-1/2017, të datës 7 dhjetor 2020, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, P.nr.399/2017, të datës 20 nëntor 2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 27 janar 2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, P.nr.399/2017, i datës 20 nëntor 2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, me aktgjykimin e lartcekur, përkatësisht me aktgjykimin e ankimuar, të akuzuarin F.A. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK dhe ndaj të njëjtit për shkak të kësaj vepre penale ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 300 € (treqind Euro), të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në të kundërtën i njëjti do t'i zëvendësohet në dënim me burgim konform nenit 43 paragrafi 3 të KPRK, ashtu që 1 (një) ditë burgim do t'i llogaritet me shumën prej 20 € (njëzet Euro).

Është detyruar i akuzuari F.A. që të dëmtuarës Drejtoria për Planifikim, Zhvillim, Bujqësi dhe Pylltari (DPZHB), Komuna e Suharekës, lidhur me kërkesën pasurore juridike t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 612 € (gjashtëqindëdhjetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në detyrim të përmbarimit ligjor.

Po ashtu, është detyruar i akuzuari F.A. që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzetë Euro) dhe në emër të fondit për mbrojtjen e viktimave të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal, si dhe për shkak të vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesën ta aprovojë si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj lidhur me vendimin mbi dënimin, në atë mënyrë që ndaj të akuzuarit F.A. të shqiptoj dëmin me burgim efektiv, me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.42/2021, të datës 20 janar 2021, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa aktgjykimin i ankimuar të ndryshohet, ashtu që ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim me burgim efektiv.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren theksohet se aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht pjesa ndëshkuese e saj është në kundërshtim me vetveten dhe arsyet e paraqitura në arsyetimin, kjo për faktin se dënimi me gjobë i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në kundërshtim me nenet 73 dhe 74 të KPRK. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë nuk ka dhënë asnjë fakt vendimtar se cilat ishin rrethanat posaçërisht lehtësuese që gjykata ndaj të akuzuarit të shqiptoj dënimin nën minimumin e saj ligjor, duke mos pas për bazë peshën e veprës penale dhe shkallën e lartë të përgjegjësisë penale të të akuzuarit, pastaj faktin se i njëjti ka qenë edhe më herët i dënuar për vepra penale të kësaj natyrës, pra është recidivist, fakt ky që edhe gjykata e shkallës së parë e kishte marrë si rrethanë rënduese me rastin e shqiptimit të dënimit. Gjithashtu, thekson se si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale është shkelur edhe ligji penal në dobi të të akuzuarit, sepse çdo pranim i fajësisë i të pandehurit nuk nënkupton që gjykata duhet të shqiptoj dënimin me gjobë, për arsye se i njëjti i gjetur në këtë situatë nuk ka pasur rrugëdalje tjetër, përveç të pranimit të fajësisë, i vetëdijshëm për veprën penale që e ka kryer dhe pasojat që ja ka shkaktuar të dëmtuarës së lartcekur, e duke i pasur parasysh të gjitha këto gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarit kishte shqiptuar dënimin me gjobë në kundërshtim me nenet 73 dhe 74 të KPRK, duke shkelur kështu ligjin penal në dobi të të pandehurit nga neni 385 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë nuk i kishte vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat rënduese, pasi që dënimi me gjobë për këtë veprë penale është tejtejet i butë dhe se gjykata nuk ka cekur asnjë rrethanë

posaçërisht lehtësuese e cila do të mund të ndikonte në shqiptimin e dënimit me gjobë, për faktin se rrethana të tilla nuk ekzistojnë. Ndërsa, theksohet se gjykata e shkallës së parë është dashur të vlerësoj intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, pasurinë e cila është pronë e Komunës së Suharekës e cila administrohet nga vet komuna, se i akuzuari është i dënuar me vendime të formës së prerë dhe atë P.nr.105/2018, P.nr.147/2018, P.nr.558/2018, P.nr.254/2018, P.nr.675/2019 dhe P.nr.773/2019, për vepra penale të natyrës së njëjtë. Po ashtu, vlerëson se me dënime të tilla nuk mund të arrihet asnjë nga qëllimet e dënimit, duke pasur parasysh faktin se i akuzuari është person i njohur nga ana e gjykatës i cili shumë herë ka rënë ndesh me ligjin, si dhe vlerëson se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret ka aplikuar politikë ndëshkimore tejet të butë, pasi që dënimi i tillë nuk ka asnjë efekt në përmirësimin e kryerësit dhe nuk mund të ndikoj në persona të tjerë që të mos kryejnë vepra penale. Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë, Prokuroria Themelore në Prizren i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si më lart.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPP, konstatoj se :

- ankesa është e pabazuar.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren janë të pabazuara. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me kurrfarë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat pretendohet në ankesë dhe as në shkelje tjera të kësaj natyre për të cilat kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1.-1.3. të KPP. Aktgjykimi i ankimuar është përpiluar sipas ligjit, përkatësisht ashtu siç parashihet në nenin 370 të KPP. Dispozitivi i aktgjyimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe i njëjti i përmban të gjitha elementet që parashihen me ligj. Dispozitivi i aktgjyimit të ankimuar nuk është në kundërshtim me vetveten e as me arsyetimin e të njëjtit, ndërsa në arsyetimin e aktgjyimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë mjaftë të plotë dhe të qartë të gjitha arsyet përkitazi me faktet vendimtare në këtë çështje penale. Në arsyetimin e aktgjyimit të ankimuar janë paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me kredibilitetin e provave konkrete, të cilat janë vlerësuar si të besueshme dhe jo të besueshme nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Gjithashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji penal, siç pretendon Prokuroria Themelore në Prizren në ankesën e saj. Kjo për faktin se veprimet e të akuzuarit F.A. i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, se për këtë vepër penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të akuzuarit.

Edhe sa i përket vendimit lidhur me dënimin, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren nuk qëndrojnë, për shkak se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ashtu siç parashihen në nenin 73 dhe 74 të KPRK. Kështu, gjykata e shkallës së parë si rrethana lehtësuese për të akuzuarin kishte marrë për bazë sjelljen e tij korrekte para gjykatës, gjendjen e tij jo të mirë ekonomike, se i njëjti është mbajtës i familjes, nuk është i punësuar, ndërsa si rrethana rënduese kishte gjetur se i akuzuari është recidivist i veprave penale të natyrës së njëjtë. Kur është fjala për rrethanat rënduese, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konsideron se gjykata e shkallës së parë është dashur që të jetë më e qartë në lidhje me paraqitjen e aktgjykimeve të formës së prerë me të cilat i akuzuari F.A. më parë ka qenë i dënuar për vepra penale. Në këtë drejtim, nuk është dashur që as gjykata e shkallës së parë e as Prokuroria Themelore në Prizren të mjaftohen vetëm me konstatimin se i akuzuari është recidivist dhe t'i paraqesin vetëm numrat e lëndëve, pa paraqitur më detajisht edhe gjykatat që i kanë marrë këto aktgjykime, datat kur janë marrë, saktësisht veprat penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor, datat kur këto aktgjykime janë bërë të formës së prerë, çfarë lloje të dënimeve janë shqiptuar, nëse këto dënime janë ekzekutuar apo jo, ku për të gjitha këto të dhëna është dashur që në shkresa të lëndës të bashkëngjiten edhe provat përkatëse, përkatësisht dokumentet nga të cilat vërtetohen këto rrethana. Andaj, në mungesë të këtyre të dhënave më të detajuara, si dhe të provave konkrete të cilat do t'i vërtetonin këto të dhëna, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës ka ardhur në përfundim se e kaluara penale e të akuzuarit nuk do të mund të trajtohet si rrethanë rënduese me rastin e matjes së dënimit. Në anën tjetër, nuk qëndron pretendimi i paraqitur në ankesë se gjykata e shkallës së parë në këtë rast ka shqiptuar dënim nën minimumin e parashikuar me ligj, për faktin se për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor është parashikuar dënim me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit, ndërsa siç është cekur edhe më lart, të akuzuarit F.A. i është shqiptuar dënimi me gjobë. Nuk qëndron as pretendimi tjetër i paraqitur në ankesë se në rastin konkret janë marrë për bazë rrethanat posaçërisht lehtësuese, duke pasur parasysh faktin se edhe ashtu të akuzuarit i është shqiptuar dënim me gjobë, i cili dënim është i parashikuar për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Gjithashtu, në ankesën e lartcekur është konstatuar gabimisht fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, përderisa nga shkresat e lëndës shihet që i njëjti nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Në këtë mënyrë, duke i pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë dhe duke i pasur në konsideratë edhe rrethanat tjera të rastit konkret, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit F.A. është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me cilësitë personale të të akuzuarit, me gjendjen e tij ekonomike dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të tij. Gjithashtu, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të

parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.19/2021, më datën 27 janar 2021

Bashkëpunëtorja profesionale,
Leonita Lajqi

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetar i kolegjit,
Beqir Kalludra

Zyhdi Haziri